



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

V E N D I M

Nr. 51, Datë 18.03.2022

PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT  
PËR PROKUROREN MANJOLA KAJANA

Në mbështetje të nenit 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, të nenit 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të germës “a”, të pikës 1, të nenit 189, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 8, të Rregullores së Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për veprimtarinë jashtë funksionit të prokurorëve”, , pasi u njoh me kërkesën me nr. 265 prot., datë 17.02.2022 dhe Relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokuroren Manjola Kajana, si eksperte ligjore në kuadër të projektit Global Firearms Programme, për të prezantuar në nivel kombëtar dhe rajonal, përmbledhjen me raste të praktikës gjyqësore mbi çështje të trafikimit të armëve të zjarrit dhe mbajtjes së tyre, të përgatitur nga ana e saj me mbështetjen e UNODC si dhe përgatitja e 20 çështjeve për bazën e të dhënave Sherlock të UNODC, për periudhën 01.03.2022 - 30.06.2022, por jo më shumë se dy orë në javë gjatë orarit të punës.
2. Të njoftohen për këtë vendim znj. Manjola Kajana dhe Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më datë 18.03.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË





ANËTAR  
SOKOL STOJANI

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
NURIHAN SEFI

ANËTAR  
ELOIDA GOXHI

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

ANËTAR  
ZEQIR HODA

ANËTAR  
SANDËR BECI

ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

ANËTAR  
LUDOVIK DODAJ

ANËTAR  
MIRELA BOGDANI